



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 14.02.2025

Nr: 100

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË**  
**DENONCIMIN NR. 7, DATË 10.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,**  
**TË PARTISË DEMOKRATIKE**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** Z. Erion Veliaj  
Kryetar i Bashkisë Tiranë

**OBJEKT:** Konstatimi i shpërdorimit të burimeve publike dhe njerëzore në mbështetje të subjekteve zgjedhore

**BAZA LIGJOR:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

**KONSTATOJ:**

Partia Demokratike, më datë 10.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 7 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

*“Z. Erion Veliaj me detyrë Kryetar i Bashkisë Tiranë, ka shpërndarë certifikata pronësie për familjet e prekura nga tërmeti i vitit 2019, në lagjen 5 Maji në kryeqytet.*

Gjithashtu në po të njëjtin denoncim është denoncuar sërisht Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Veliaj si vijon:

Data: 14.02.2025

Nr: 100  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 7, datë 10.02.2025 të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

*“ Kryetari i Bashkisë Tiranë ka deklaruar në mënyrë publike se “Në shtator, Tirana do të jetë qyteti i parë në Shqipëri ku të gjithë nxënësit e shkollës 9-vjeçare, do të kenë drekën e përfshirë dhe do të qëndrojnë në shkollë deri në orën 16:00 pasdite”.*

Nga sa më sipër çmohet se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**